





PËLLUMB KULLA  
**SALLAKU**  
**OSE SI QESHNIM NËN DIKTATURË**  
ESE - PORTRET

---

BOTIMET TOENA



PËLLUMB KULLA

**SALLAKU**  
**OSE SI QESHNIM NËN DIKTATURË**

*ese - portret*

BOTIMET TOENA  
Tiranë

Botuese: Irena Toçi

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Korrektore letrare: Edona Marku

Përkujdesja grafike: Mirjana Madhi

Kopertina: Fllad Kulla

ISBN: 9789928376756

© Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi me asnjë lloj mjeti ose forme, as me fotokopje, pa lejen me shkrim të mbajtësit të copyright-it

BOTIMET TOENA

Rr. “M. Gjollesha”, K. Postare 1420, Tiranë

Tel. +355 4 22 40 116

Email: [botimet.toena@gmail.com](mailto:botimet.toena@gmail.com)

[toena.porosionline@gmail.com](mailto:toena.porosionline@gmail.com)

<https://toena.al>

## *Misione dhe misionarë*

### *Parathënie*

Është e dyta herë që lexoj këtë libër të Pëllumb Kullës... Ndodhi, nuk e gjej, hëpërhë, arsyen sesi, por herën e dytë më pëlqeu më shumë sesa herën e parë. Është aq e vërtetë kjo, - sado e çuditshme qoftë! - sa më lindi mendimi të shkruaj dy fjalë për të tre miqtë e mi të mirë: për librin, Pëllumbin dhe Skënderin. (Më falni për renditjen!)

U ula të shkruaj por... ngeca. Në momente të tilla stilolapsi bëhet më i rëndë se shtanga e peshëngritjes. Çfarë duhet të thosha apo mund të thosha, për një libër që shoqërohet nga dy parathënie dhe një pasthënie?!

Lufta ishte brenda meje “po”, dmth. të shkruaj dhe asaj “jo” dmth. çfarë do të shkruash, janë thënë të gjitha! Më çliroi një thënie e bukur që na bind se çdo vepër artistike i ngjan një skulpture të rrumbullakët që mund ta shohësh nga shumë anë. Dhe më duket se gjeta edhe unë shtegun apo anën time, nga duhet të kaloj për të qenë ndryshe dhe origjinal.

Shpesh në bisedat tona, sidomos ne artistët e skenës dhe ekranit, kur duam të vlerësojmë një veprimtari apo projekt

të rëndësishëm përdorim shprehjen: “Që të vësh në skenë Hamletin, duhet të kesh Hamlet!”. Pra, nevojitet aktori që do të luajë atë rol. Në këtë libër Kulla e ka gjetur Hamletin për veprën e tij: ai quhet Skënder Sallaku!

Ia kam thënë vetes, ashtu si edhe mijëra e mijëra të tjerë para meje e kanë thënë, që forca e humorit qëndron te serioziteti i tij. Në pamje të parë duket sikur ky binom apo, quaje simbiozë, nuk shkon. Humor plus seriozitet?! Nuk është ashtu. Serioziteti bëhet edhe më i fuqishëm kur përcillet me humor. Serioziteti i humorit është mesazhi që ai përcjell dhe sa më i thellë të jetë humori aq më i fuqishëm bëhet edhe mesazhi. Libri i Pëllumbit ka një titull dhe një nëntitull: “Sallaku ose si qeshnim nën diktaturë”.

Skënder Sallaku i ngjan atij kalorësit modern që ka marrë përsipër të përcjellë te njerëzit mesazhin e kohës, aspiratën e popullit me armën e tij të preferuar, humorin. Fusha e betejës është diktatura. Dhe ai e ka bërë këtë luftë ndonëse fjala “luftë” nuk është ndër termat e humorit, dhe për më tepër, këtë betejë, e ka zhvilluar në një terren tmerrësisht të rrezikshëm.

Por ai, ia ka dalë të fitojë. Skënderi apo kalorësi ynë, është shquar në shumë fusha të jetës publike, por Pëllumb Kulla e ka fokusuar atë në pjesën më të vështirë dhe më të rrezikshme: në terrenin politik. Ndoshta për këtë arsye shpesh nëntitulli i librit bëhet titull.

Skënderi, siç tregohet në libër, është një artist dhe them artist dhe jo aktor, sepse ai ishte i disaanshëm, megjithatë unë, si konsumator dhe krijues në gjininë e humorit, por edhe si mik i tij, do të thosha se “kali i betejës” i Skënderit ishin barsoletat, gazmoret, veçanërisht ato nga burimet popullore.



E kam parë njëherë kur isha i ri në teatrin e vjetër të qytetit tim, teksa ai interpretonte një monolog. Monologu shoqërohej nga ovacionet e publikut, sa kur mbaroi kërkuan ta përsëriste, pra e thërrisnin për bis. Skënderi e dinte që për së dyti monologu nuk do të kishte suksesin e parë, ndaj kishte gjetur një mënyrë tjetër për të kënaqur bis-in: thoshte një batutë dhe dilte gati me vrap. Reagimet ishin edhe më të fuqishme, sesa ato që shkaktoi monologu. Skënderi dilte prapë thoshte një batutë tjetër dhe largohej përsëri me vrap. Atë natë ai e përsëriti këtë gjë, të paktën shtatë herë.

E solla në kujtesë këtë episod për të thënë, se arma që ai përdorte më mirë, pos karaktereve, ishte mjeshtëri i batutave gazmore. Në tregimin e anekdotave në skenë dhe sidomos në tavolinë, ai ishte mbret. Edhe në qoftë se tavolina ishte vetëm me artistë, mbreti do të ishte ai, Sallaku. Dhe ju duhet ta dini se sa e vështirë është të zgjidhesh mbret mes artistësh. (Është më e vështirë sesa të zgjedhësh një president!)

Me këtë armë, pra me humorin e gazmoreve ai arriti të futej deri në “gojën e ujkut” dhe t’u shpëtonte dhëmbëve të bishës. Vetvetiu lind pyetja përse doli pa u kafshuar hiç?! Pëllumbi në libër përpiqet dhe shpjegon disa arsye bindëse, por unë që kam pasur rastin ta dëgjoja dhe bisedoja me Skënderin disa herë, them se ai kishte një mjeshtëri apo naivitete, një ndershmëri të çuditshme sa çdokush që e dëgjonte qeshte dhe i jepte të drejtë për atë që thoshte duke ia kursyer e duke mos e kthyer kokën andej nga binin shigjetat. Dhe arsyeja tjetër madhore ishte se ajo që tregonte ai ishte e vërtetë. Mbase mbi mjeshtërinë e tregimit vetë pozicioni i Skënderit si artist misionar iu dha atij nga njerëzit, monopoli, licenca, autorësia e tërë batutave të

mençura dhe të bukura të kohës me pëshpërimën: “A e dini këtë të fundit që ka thënë Sallaku?”.

Kam rastin më të mirë të shpreh dhe një ide të rëndësishme: Me këtë libër dhe mënyrën e trajtimit të tij Pëllumbi me “ndihmën” e Skënderit sjell edhe një herë mesazhin se humori e ka forcën te serioziteti i tij, gjë që aktualisht nëpër spektaklet aktuale shfaqet si qenie e rrallë.

Dhe më duhet patjetër të vlerësoj autorin e librit, kolegun dhe mikun tim të vjetër për atmosferën që ka sjellë duke përshkruar dhe duke u ndalur edhe në të përditshmet e sofrave, ku gatuheshin komeditë e vogla dhe të mëdha, që pasi ato merrnin certifikatat e pastërtisë bëheshin pjesë e humorit zyrtar që ushqente masat. Aq më tepër që në libër gjen rast të bëjë një homazh edhe për artistët e mrekullueshëm që parakaluan dhe u plakën nëpër skenat e estradave dhe ekranet e vendit. Dhe aq më tepër për vendin që u ka lënë në faqet e librit të tij artistëve të huaj, të njohur dhe të panjohur që zbavitën masat dhe brejtën regjimet diktatoriale në hapësirat e perandorisë bolshevike.

Sa i bukur tingëllon ai paralelizmi midis Sallakut tonë dhe rusit Jurij Nikulin!

### *Si mbyllje*

Dhjetë vjet më parë, aty nga fundi i vitit 2013, djemtë e mirë Pëllumb Kulla, Robert Ndrenika, kryebashkiaku i Fierit Baftjar Zeqaj në hyrje të qytetit, në atë vendin buzë lumit Seman, ku me lopatën e betonit në duar pat derdhur djersë i “dënuari” Kujtim Spahivogli, martiri ynë i paharruar, ngritën dhe organizuan përrurimin e një përmendoreje në nder të tij. Me fjalime prekëse dhe me duartrokitje të zjarra

u tërhoq mbulesa dhe u shfaq basorelievi i bukur, vepër e mjeshtrit skulptor Muntaz Dhrami.

Një koktej plot rikujtime vazhdoi pastaj në njërin nga lokalet aty pranë.

Në rendin e fjalëve të rastit, më saktë në mbyllje të tyre, autori i librit që keni në duar, i cili bënte moderimin në atë koktej, ia dha fjalën personazhit të po këtij libri:

“Dhe tani, pa u trembur më, le të dëgjojmë një ish-sekretar të asaj partie, që kur e kujtojmë na hyjnë të dridhurat. Zonja dhe zotërinj, Skënder Sallaku!”.

Në mes të të qeshurave të bujshme dhe duartrokitjeve Pëllumbi i dorëzoi mikrofonsin mikut të tij duke shtuar:

“Mos ma more për keq, Skënder, por më duhej t’i paralajmëroja të pranishmit dhe nëse ndonjëri që nuk do t’ju shohë me sy ju sekretarëve, kishte për t’ia mbathur, le t’ia mbathte!”.

Skënderi nuk ia vonoi përgjigjen:

“Mor po çfarë patën për t’ia mbathur nga ne, ia mbathën, po shiko këta që po ia mbathin nga kjo demokracia juaj!”.

Nuk ishin gjë të qeshurat e mëparshme. Batuta e Sallakut e tundi dhe e shkundi restorantin buzë Semanit.

Mua që ndodhesha aty në atë ditë plot diell, më pëlqeu dhe më preku pa masë ky dialog, që dukej si i marrë nga faqet e para të librit të Pëllumb Kullës teksa autori dhe personazhi prisnin vizitën e Xhejms Bejkerit! Përgjigjja vërtetonte se misioni i kalorësit të kohëve moderne, me ato shigjetat drejt qiellit të Zotave vazhdonte!

Dhe jam i sigurt që apelonte misionarë të rinj të racës së Skënder Sallakut.

**HAXHI RAMA**  
REGJISOR



## *Hyrje e shkurtër*

Jo vetëm më të rinjtë, por edhe ata që e ndiejnë ende mbi tërë qelizat e veta peshën e verbër të shtypjes komuniste, duke kaluar vitet, kanë filluar të rreshtojnë një radhë me pikëpyetje nëse qeshnin apo jo njerëzit gjatë dhjetëvjeçarëve të rënduar nga mungesat e mëdha të lirisë, të ushqimit dhe lejes për t'i hedhur një sy botës përçark.

Të rinjtë sot, i përfytyrojnë njerëzit e asaj kohe të zymtë, gojëkuçur, të zënë tërë kohën me hallet e jetës, me pasigurinë e bukës së përditshme dhe me merakun se mos bindjet, opinionet dhe shijet e tyre, do të binin në sy që ishin ndryshe nga ato që pat përcaktuar shteti.

Përfytyrohet pra, vetëm një shkretëtirë trishtimi gri, pa fund...

Por ne qeshnim... Oh, sa shumë qeshnim! Dhe jo nga pavetëdija e trysnisë apo moskokëçarja. Tani pas disa vjetësh endjesh nëpër botë, mua më duket se nuk kam parë këtej, të qeshet aq sa qeshej dikur në Shqipëri. Madje unë mendoj, se as në vetë Shqipërinë e sotme, nuk qeshet aq sa qeshej dje. Vaji merret me mend, por edhe gazi dhjetëra vjet më parë, ishte më me shumicë se tani.

E gjitha kjo ngjan si një dëshmi e favorshme në gjyqin historik të regjimit komunist. Që të jemi të drejtë, e qeshura jonë e atyre viteve i detyrohet regjimit, por aspak si bindje ndaj urdhrit suprem të tij që shtetasit të ishin medoemos të lumtur; (edhe pse vetë lumturia sipas teorisë së tyre të fazave të zhvillimit, do të vononte disa breza).

Në përshkrim të mynxyrave të regjimit komunist, janë shpenzuar male me letër e dete me bojë të zezë, por ky libër këtë radhë, nuk do të merret me gjëmat. Ai regjim ishte i egër, i dhunshëm, i pamëshirshëm, shkatërrimtar, sa për të përmendur ca epitete të thëna e të përligjura. Por ai ishte njëkohësisht edhe qesharak, grotesk... Pushteti shtazarak nganjëherë jeton edhe me shekuj, por kur merr trajta qesharake, ai bëhet më i thyeshëm, pasi u jep shpresa të prekshme shumicës që e përbuz dhe i tremb ithtarët e vet të pakët, që ia vënë re këtë anë të zbuluar, të cilën garnizone të tëra nuk ia mbrojnë dot.

Jo gjithmonë e qeshura është dëshmi e lumturisë. Për dekada të tëra, e qeshura na u bë në një lëvizje, një zhguall i fortë, që mbështolli qenien tonë, gjallërinë dhe shpresat tona. Dhe kishte vërtet aq shumë me se të qeshje: reforma, plane, udhëzime, tufëzime, statistika, shtrembërime, aleanca, festa, fjalime, shefa dhe vartës, gjykatës dhe të goditur... Ishin plot gjëra, të cilat me urdhër nga lart, jo vetëm që nuk duhej të merreshin qesharake, por madje duhej të trajtoheshin si të shenjta dhe solemne.

Kjo e bënte edhe më të bujshëm gazin tonë.

Që kishte aq shumë dukuri qesharake, nuk ishte as merita dhe as faji ynë, ama që ne i gjenim ato, kjo ishte falë pasurisë sonë shpirtërore dhe papërkulshmërisë. Se kur dëshpërimi i kalon kufijtë e shpresa nuk të ngre dot nga ku

ke rënë, ti nuk qesh më. Ti atëherë je dorëzuar. Njeriu që nuk shpreson se do të ngrihet më këmbë, nuk e sheh dot qesharaken dhe nuk qesh.

Ne shpresonim të ngriheshim, pamë dhe vazhdimisht qeshëm...

Kishte aq shumë lëndë mbi çfarë të qeshnim, por falë i qofshim Zotit, u gjendën edhe mjeshtër, që e gatuanin dhe e servirnin atë. Patëm në mesin tonë mjeshtër të jashtëzakonshëm, të njohur dhe të panjohur.

Njëri prej këtyre të njohurve është Skënder Sallaku, një artist cilësisht i pasur me dhunti të natyrshme, plotësuar këto me një përgatitje të gjatë rraskapitëse e profesionalisht të përsosur. Emri i tij dhe imi, hera-herës rreshtoheshin tok në fushën ku punuam vite, veç dhe bashkërisht, për aq e aq spektakle gazmore. Por unë nxitoj të them, se ky libër nuk është aq për të qeshurën e përgatitur në ngrehinat shtetërore, siç ishin estradat, teatrot e koncertet, as për veten dhe madje, paradoksalisht, ky libër nuk është tamam as për Sallakun. Shfaqjet tona të mirafishuara ishin aq të varfra me plazmën të cilën po përgatitem të derdh unë këtu, sa në vend të një vetëpërgëzimi këto fletë libri rendin drejt një shfajësimi. Veçse frika jonë ishte tërësisht e përlligjur, pasi nuk ishte kollaj të thoshe më shumë mbi skenë, nën tmerrin e ndëshkimit që nuk kursente askënd. Artistët tanë që gatuanin humorin për skenën, radion dhe TV-in, patën meritë të madhe për atë pjesë gazi të shëndetshëm, që i sollën bashkëkohësve, por temat e mëdha, afërmendsh, nuk mundën t'i prekin.

Vetë Skënder Sallaku, që do të mbretërojë në faqet e këtij libri, nuk bëri përjashtim. Ai nuk tha dot e nuk u përpoq kurrë të thoshte që nga skena ndonjë gjë historikisht mbresëlënëse,

a tronditëse. Zoti na ruajttë! Por duke qenë një artist mjaft popullor, një emër shumë komod, atij iu veshën pothuaj të gjitha gazmoret e helmëta, ato që i kishin majat e shigjetave përpjetë dhe qëllonin lart, shumë lart. Në shëtitjet e mbrëmjes, a në tryezat që besoheshin se ishin larg ndonjë veshi të keq, njerëzit afronin kokat dhe me zë të ulët pyesnin: “E morët vesh këtë të fundit të Skënder Sallakut?”. Dhe tregonin me ashk një shprehje, një barzeletë, një frazë, për të cilën mund të shkoje në burgjet ku nëntëdhjetë për qind e atyre që i popullonin, nuk kishin thënë asgjë të këtij lloji.

Shkëndijën për këtë libër ma dha Vitorja, e shoqja e Skënderit, e cila kish filluar të hidhte ca shënime, duke u përpjekur të afrohej në përcaktimin e vlerave profesionale të të shoqit, si artist. Vura re se në fletët me kujtimet e saj, kish plot,(e si mund të qe ndryshe!), nga rrëfenjat “e hidhura” që nuk mund të mungonin pasi ky tipar i veçantë i tij, kishte lënë gjatë rrugës një mbresë të pashlyeshme.

E mora unë përsipër këtë barrë të këndshme me kredencialet e njeriut që është marrë me prashitjen e këtyre lloj arave. Unë do të përpiqem t’u tregoj artistëve të rinj, se si e qysh Skënder Sallaku, me djersën që derdhi, i begatoi dhuntitë e rralla që i fali natyra, por vendin kryesor në këtë libër do ta ketë aventura e tij e gjatë me ato tregimthe zbavitëse, të cilat tani kanë thjesht një vlerë arkivale.

A ju ka zënë syri njerëz që ndalen të shohin, me admirim e zemër të ngrirë tok, një fëmijë që marrëzisht zbavitet tek kalon mbi tubin e një ujësjellësi, 20-30 metra sipër një përroi shkëmbor me thepa të egër atje në fund të humnerës? Ata i kthejnë krahët fëmijës që ka kaluar përroin dhe më pas vazhdon ecjen mbi tub, sipër një livadhi të butë, që shtrihet aty ca pëllëmbë më poshtë. Kureshtarët nuk kanë më interes



edhe pse qafa e tubit është po ajo e zotësia po ajo. Por nuk është po ai rreziku. Ashtu edhe këto anekdota tani të japin të kuptosh se vlera e tyre e vërtetë ishte tok me rrezikun.

Por prapë mbi këtë artist të rrallë e të guximshëm ka shumë për të thënë: mënyra se si i tregonte, efekti që ato bënin, njerëzit që e rrethonin e që qeshnin me të.

Vendosa pra t'i shkruaj këto faqe, duke dashur që të përziej në të miellin dhe furrтарin, me shpresën e patundur, se nga faqet e këtij libri, Sallaku do të na vijë i ri, çapkën, kloun, vëzhgues, mbledhës i nektarit gazndjellës dhe tregimtar i këndshëm...



Kapitulli i parë

## **E qeshura si dëshmi e shëndetit, jo e lumturisë**

*Gëzimi i përmbysjes - Popull dhe popullaritet  
- Kripëmjalhtëza - Legjenda dhe monopoli  
- Ministri argëtohet me trafikantët e humorit*



## Gëzimi i përmbysjes

Në një ditë të bukur pranvere të vitit 1991, në sheshin “Skënderbej” të Tiranës, qindra mijëra njerëz prisnin vizitën e Sekretarit të Departamentit të Shtetit amerikan, Xhejms Bejker. Ishte ardhja e parë e një shtetari amerikan në Shqipërinë tashmë të hapur ndaj botës, pas gjithë asaj mbylljeje të urdhëruar nga regjimi komunist e zgjatuar afro një gjysmë shekulli. Monumenti gjigant i Enver Hoxhës ishte gremisur e nën shtrëngatën e pështymave, ish hequr zvarrë nga sheshi i madh. Tani ngjante sikur e tëra kjo qe bërë për t’i lënë vend podit të lartë, ku do të pritej përfaqësuesi i botës së lirë. Në ato javë të papërsëritshme plot diell, njerëzit nuk dinin as si ta pinin për ta shijuar më mirë poçen e kohës: e ngrinin gllënjë pas gllënjke dhe në çdo dy orë, pickonin veten se mos ishin në ëndërr.

Me gumëzhitjen e tyre rrugët premtorin një pritje të paparë ndonjëherë në histori.

Për të soditur këtë pamje të rrallë, kishim kërkuar një pikë vështrimi të patrazuar nga njerëzit, nga ku të shijonim tërësinë e festës: ardhjen e makinave, morinë e njerëzve pjesëmarrës në pritje, mijërat e flamurëve kombëtarë e amerikanë, që shkriheshin tok në një valëzim, fytyrën e mysafirit e pastaj fjalët e mirëseardhjes e gjithçka lidhej me këtë festë.

Zgjidhja e mikut tim Ilir Bezhani, ishte e përkryer: u vendosëm në ballkonin e apartamentit të ungit të tij!

Kështu, një orë para se Bejkeri të ngitej në tribunë, ne ishim ulur në një ballkon të katit të pestë në “Rrugën e Durrësit”, nga do të vinte vargu i makinave. Që atje lart ne mund të shikonim djathtas fundin e rrugës, majtas hyrjen në

sheshin e madh dhe tribunën e ngritur me ngut, në krah të Kastriotit mbi kalë. Bash prapa derës së ballkonit me ekran të kthyer nga ne, kishim afruar një ekran televiziv. Në të gërshetoheshin pa pushim pamje të aeroportit, të sheshit, të vargut të policëve, që gatiteshin të përballnin valën e turmës së përndezur, fëmijë që prindërit i ngrinin lart mbi supet e tyre, për të parë se mos vinin veturat, kur ende nuk pat zbritur avioni që do të sillte Sekretarin e Shtetit amerikan.

Në ballkonin e katit të katërt, jo tamam ndën ne, por pjerrtas, banorët po nxirrnin disa karrige për të parë edhe ata këtë spektakël, që gjithkush e priste madhështor.

“Është ballkoni i Skënder Sallakut!”, më tha Iliri.

Pas pak minutash, Sallakët u vendosën nëpër karrige dhe ngjatjetuan familjet e tjera të dala në ballkonet përreth. I fundit doli komiku i shquar, koleg dhe mik i vjetër imi dhe i Ilirit. Skënderi vështroi lart nga ne, e vuri re për pak sekonda praninë tonë të pazakontë dhe pastaj bëri drejt nesh një reverancë të thellë, që edhe Bejkeri vetë do të na e kishte zili.

“Po ti?!”, i thashë që sipër unë, në vend të mirëmëngjesit. “Edhe ti po del në ballkon?! Ky që vjen është mysafiri ynë. Ju komunistët nuk keni punë me të.”

Skënderi zuri vend në karrige dhe me zë të lartë iu përgjigj menjëherë goditjes sime, me dialektin e tij të zhdërvjelltë tiranas: “Ne komunistët jua sollëm. Ka thonë partia jonë: çfarë do populli bon Partia! Ju sollëm Hrushovin, Çu En Lain... Me meny! Duam Bekerin! Qe, edhe Bekerin! Por amo’, gjithë knej, kah ky bulevard, konë kalu e njikshu, jon pritë. Pse kam përshtypjen unë, se në ato pritje që përmende ti, populli ka pasë dalë në rrugë me urdhër? Urdhri ka qenë pjesë e organizimit. Këtë radhë, sot, partia jonë e organizoi

të lirë. Dhe kjo demokraci e kjo liri, me urdhër partie erdhën: merrni lirinë! Kush nuk merr lirinë, e pret burgu!”.

Kjo ishte gjuha tipike e Skënder Sallakut. Në radhët e partisë komuniste që prej mbi një duzine vjetësh, Sallakut i pëlqente si një shend i lehtë parodie, të folurit në emër të partisë, me slogane nga më të strepsurit prej përdorimit. Vite me radhë, ajo ishte një si lloj përqeshje e lehtë, elegante dhe e përmabajtur.

Në ekranin prapa nesh, po jepej zbritja e Bejkerit në Rinas. Turma, poshtë ballkoneve tona në të dyja anët e rrugës këtë nuk e shihte. Ajo përgatitej të shquante shfaqjen e afërme të veturave. Njerëzit po i lodhnin para kohe majat e gishtave të këmbëve duke u munduar të shihnin mbi kokat e të tjerëve. Policët shtynin valët e njerëzve për të lënë një korridor të mjaftë për karvanin e gjatë të automjeteve që do të vinin. Si për të bërë provat e pritjes, njerëzit brohorisnin:

“Bejker - Bejker! Ju es ej - Ju es ej!”.

Dialogu ynë me Skënderin vazhdonte:

“Eh, si ju vrasin sytë juve këto pamje!”, rifillova unë. “Eh, si ju buçasin veshët nga këto brohoritje të gëzueshme të popullit! Eh, çfarë vreri duhet të shkrumbëzojë në zemrat tuaja komuniste!”.

“Ta dini ju, mor budallenj, sa ka punu’ partia jonë për këtë ditë, për këtë gëzim! Asnji nuk kishte për të dalë me e pritë amerikonin sot, po të mos ia kishim marrë shpirtin këtij populli për 50 vjet! Vetëm për me mrritë ke ky gëzim e kena bo’! Vetëm për hatër të amerikonëve! Nji, t’ju shohim juve, që jua lamë pushtetin, kur të vijnë amerikonë të tjerë knej e tutje: vetëm të nesërmen, prej gazetave ka për ta marrë vesh mileti, që këtu kan’ ardhë amerikonë!”.

Më pas vargu i veturave u duk vërtet dhe ne nuk e shtymë më gjatë dialogun. Na përpinë të gjithëve episodet e rralla të shfaqjes së gëzimit, ato që vetë Sekretari i Shtetit Bejker, do t'i përshkruante më pas në kujtimet e tij, si dëshmi të pritjes më madhështore dhe më prekëse, që i është bërë ndonjëherë në jetën e tij: qilimat që hera-herës i shtronin para veturës së tij; tentativat për ta ngritur peshë automjetin, që po e sillte në këtë vend aq të sflitur nga barra e rëndë e diktaturës më të egër komuniste; njerëzit që puthnin pa prerë dyert dhe dritaret e veturës; lulet që hidhnin fëmijët mbi xhamat dhe çatinë e saj; lotët që rridhnin mbi faqet e grave dhe burrave, thinjur e thyer nga kjo pritje, që deri pak javë më parë u dukej pa fund.

Veturat e çanin rrugën me vështirësi, pasi policët ishin zhveshur nga gjithë rreptësitë që zotëronin, duke përfshirë edhe atë të rregullit minimal rrugor, ende tepër i nevojshëm, pavarësisht nga ndryshimet politiko-shoqërore që përjetoheshin ato ditë.

Sapo spektakli rrëshqiti mbi rrugën poshtë nesh dhe u përpi nga turma që mbushte sheshin e madh, ballkonet u boshatisën si me urdhër. Të gjithë u futën nëpër apartamente, për të ndjekur në ekranet e televizorëve fjalët e mirëseardhjes dhe mirëseggjetjes. Edhe Sallakët po e boshatisnin ballkonin.

Para se të hyja në apartamentin e Bezhanëve, i hodha një vështrim të fundit Skënderit, i cili ende nuk pat lëvizur nga vendi. Ajo që kish ndodhur para syve tanë, e kish shtënë në mendime të thella dhe komiku nuk u kthye më, as të vazhdonte me mua romuzet në dialogun e ndërprerë e as të shkëmbente mbresat me ne. Ne përjetonim, jo një vizitë shtetërore, jo ardhjen e një përfaqësuesi nga vendi më demokratik i botës, jo një premtim lumturie, që vendi më i



begatë i rruzullit dukej se atë ditë e dërgonte me lajmësin e tij më të shquar. Atë ditë prekej me dorë një tabu hijerëndë dhe hapej mbi botën e lirë një portë, së cilës i rrapëllinin hekurat e ndryshkur.

Skënderi, ky njeri, që të gjithëve u lë përshtypjen se ndaj fenomeneve të madhërishme nuk është kurrë aq sa duhet serioz, ndihej se kish mbetur i shokuar nga ajo që pat ndodhur poshtë nesh dhe po vazhdonte të ndodhte më me zjarr në rrugën drejt tribunës. Mua më dukej se në atë meditim, ashtu mbështetur mbi hekurin e ballkonit, ky artist i vyer, po kuptonte se fantazia e tij e ndezur, ia pat sjellë mijëra herë pritjen e Bejkerit në ëndërrimet e tij, por jo, kurrë me bukurinë e sotme! Përsëri unë dyshoja se Skënder Sallaku nuk kish as vetëdijen më të vogël, se sa shumë pat bërë ai vetë, që vendi të vinte te kjo ditë. Teksa për vetëdijen e turmës isha i sigurt fare: ajo turmë që zgjatej poshtë ballkonit dhe mbushte sheshin, nuk e kuptonte se këtij njeriu që i pat lehtësuar natën e gjatë, ajo i kish borxh një pjesë të gjallërisë, të gëzimit të lirisë, i kish hua një pjesë të shpresave dhe të mbijetesës.

## **Popull dhe popullaritet**

Ende djalosh, si tërë moshatarët e mi, mua më pat tërhequr si magnet arti i tij i mrekullueshëm. Jo më shumë se një admirues atëherë, unë zija radhë qysh në agim për të siguruar një biletë për shfaqjet ku luante Skënder Sallaku. Pas disa vjetësh u bëra i afërt me të si koleg: shkrimtar i miniaturave humoristike dhe regjisor spektaklesh. Dhe që atëherë jam i lumtur që bëra pjesë në rrethin e miqve të tij. Për mua, ka

qenë gjithnjë kënaqësi puna dhe të ndenjurit me të. Biseda me Sallakun nuk shmangte asnjë nga temat e rëndësishme që brengosin gjithë të tjerët. Veçse ajo ishte pafundësisht e gëzueshme, diçka e veçantë, e lehtë, tërë kohën e ilustruar me një episod, apo me një karakter zbavitës.

Si artist, Sallaku e pati hovin në një periudhë kur televizioni pothuaj nuk ekzistonte, por kjo nuk e pengoi famën e tij të përhapej dhe emrin e tij të bëhej i dashur për fëmijët, të rinjtë dhe të moshuarit. Kishte edhe në periudhën e parë të krijimit të trupave komike të estradave artistë të shquar, por veprimtaria e Estradës së Tiranës dhe e cirkut të përfshirë në të, ishte më e gjerë dhe mbulonte më mirë nga të tjerat, gjithë viset e Shqipërisë. E për popullaritetin e Skënderit, kjo ishte një përparësi jo e pakët. Nga artistët e tjerë, ai shquhej për pasurinë e gjerë të cilësive mjeshtërore aktoriale, përveçse angazhohej gjerësisht në cirk në cilësinë e klounit, kërcyesit, akrobatit, madje edhe të zhonglerit. Efekti i mjeshtërisë së tij arrinte në atë hare dhe gaz të përgjithshëm, sa vinte e krijohej ajo dehje e ndërsjellët, ku loja mjeshtërore e përnatshme e humbte përkufizimin “punë” e shndërrohej për vetë Skënderin, në një festë zbavitëse. Kishte, pastaj, një komunikim mrekullisht të shpenguar, me ata qindra vetë që tendosnin qafat e mbërthenin tek artisti sytë e tyre të ndritshëm e hera-herës të përlotur! Aq e atypëratyshme bëhej loja, sa salla shpërthente në gaz të beftë, kur Sallaku u jepte mallkimin “plaç!”, edhe krismave të rrufesë në rrebeshin, që rastësisht atë mbrëmje binte jashtë. Kur ishte e paraparë në skenar, ai e thyente fare lirshëm “murin e padukshëm”, që ndante skenën me sallën, atë “mur të katërt”, që shumë aktorë nuk e kapërcejnë dot. Pastaj, kur e çante edhe me hapat e tij, krijohej një panair i

hareshëm nga ata “nëm Zot sy të shoh e veshë të dëgjoj!”. E Sallaku derdhej me zell në mes të publikut, i cili ndryshonte mijëra herë nga dita në ditë e nga qyteti në qytet.

“Hej, Skënder”, i tha një ushtar njëherë, para se të fillonte një nga shfaqjet që bënin diku në periferi të vendit, për një njësi artilerie, “më mban mend apo...?”

Një grup ushtarësh të tjerë, rrinin prapa shokut, me sa duket të ftuar prej tij, për t’u vërtetuar atyre, se historia që tregonte hera-herës në fjetore se me Sallakun ishin të njohur të vjetër, ishte e vërtetë.

“Turp më vjen”, ia ktheu Sallaku, “por nuk më kujtohesh?”

“Mbase ngaqë më shikon ushtar tani, me kokë të qethur...”

“Mundet”, i dha të drejtë Skënderi.

“A ke qenë në Kukës, para dy vjetësh? Kur dhatë atë shfaqjen në sallën e kinemasë, ëh?”

“Po...”

“Unë kam pasë qenë ulur në radhën gjashtë, karrigia trembëdhjetë... Të kujtohet tani? Ëh? Radha gjashtë, karrigia trembëdhjetë! Të gjithë po të duartrokisnin. Ti zbritte te radha ime dhe më vure dorën në sup...”

Skënderi nuk ia prishi përfytyrimin ushtarit:

“Shih, shih! Tani po më kujtohet. Si more çun, nuk të mbaj mend! Eja more, të të puth! Po sa paske ndryshuar more shejtan! Qenke bërë burrë. As ma merrte mendja, se do të të gjeja këtu!”

Ushtari kuksian shikonte rreth e qark me krenari shokët, që për këtë goxha miqësi, ia kishin vërtet zilinë.

Duke filluar nga vitet ’60, pa lëkundje, duhet thënë se Skënder Sallaku ishte personi publik më i dashur në

Shqipëri. Vetëm ndonjë futbollist i shquar i kohës, mund të matej me të, në simpatinë gjithpopullore. Por Skënderi bëhej i paarritshëm edhe falë natyrës së tij komunikuese dhe thjeshtësisë, me të cilën ndalej në bashkëbisedim me njerëz të zakonshëm: fshatarë, studentë, militantë partie dhe të persekutuar, policë, nëna me fëmijë... U përgjigjej me mirësjellje të ngutshme pyetjeve që i bënin që nga dritaret e autobusëve urbanë, nga rreshtat e shkollarëve dhe ushtarëve, nga verandat e kafeve e nga trotualet. Janë ato lloj ngacmimesh, kur ihtarët duan t'i tregojnë idhullit të tyre, se edhe ata dinë të bëjnë humor. Në sallat e shfaqjeve pastaj, ai i takonte përsëri, por këtë radhë në marrëdhënie të tjera. Dashuria dhe hareja e syve të tyre, i dukej si shpërblimi më i natyrshëm i mundit të tij. Ato ishin më të vlerata edhe se vetë rroga, që si gjithë rrogat lart e poshtë vendit, ishte e pakët dhe e rrafshët me ato të gjithë artistëve, që nuk kishin aspak mjeshtërinë dhe karizmën e tij, por kishin privilegjet që garantonte socializmi. Sallaku i deshi deri në dhimbje këta spektatorë që caktonin të shtunat, të dielat, pasditet ose mbrëmjet dhe vinin, (shpesh dhe nga qytete të largëta tok me fëmijët), e çlodheshin në shfaqjet e tij, duke derdhur lot gëzimi në gjithçka thoshte e bënte artisti famëmadh. Ata shpërthenin në gaz sa herë aktori mundohej, për shembull, të bënte të qëndronte më këmbë një të vdekur, gatuante si kuzhinier mendjefyell, apo sa herë përgatiste frazën kyç, atë përfundimtare, të cilën zakonisht Skënderi e godiste si me varë:

*Njëherë aty nga viti 1946, kur në vendin tonë zhvilloheshin kurset kundër analfabetizmit që ishte aq shumë i përhapur, në një shtëpi trokiti një nga aktivistët që regjistronin njerëzit*

*për në kurset e mbrëmjes. Portën e hapi një burrë me syze, i veshur me pizhame.*

*- Urdhëroni, - i tha aktivistit. Ky pështyu lapsin e bëri gati listën. - Emrin, - i tha. - Përse e doni emrin tim? - pyeti burri. - Emrin! - i dha urdhrin aktivisti. - Dua të të regjistroj në kursin kundër analfabetizmit! - Po, shikoni, - i tha i zoti i shtëpisë, - ka një keqkuptim. Unë kam kryer një universitet, jashtë shtetit!*

*Aktivisti pështyu lapsin e i tha universitarit:*

E këtu Skënderi hynte në stinën e të korrave. Ai tani do të shijonte vetë e do të ftonte publikun në kënaqësinë e zbulimit të shkretëtirës në trurin e aktivistit të Frontit. Me një zbardhje tutkune sysh e me një siguri zëri autoritar, komiku shfaqte copë dhe hapur, që i gjithë ky tregim, bash për të thënë atë të shenjtën frazë mbyllëse, ish thurur deri këtu:

*O i zoti i shtëpisë! Thuaje emrin! Bëje dhe këtë kurs se qarr e ke! Kush ka parë keq nga shkolla! Pthtu: emrin!...*

Kjo është njëra nga gazmoret që tregonte Sallaku në skenë. Të tilla gazmore, mbi paditurinë e hershme të njerëzve të Frontit Demokratik, që ishin në fakt shërbëtorët më të zellshëm të “pushtetit të vegjëlisë”, tregoheshin ende në skenë e shkruheshin shpesh nëpër faqet e shtypit humoristik, aty nga fillimi i viteve '60. Por atëherë lihej të nënkuptohej, se kjo fazë foshnjore e pushtetit të ri ishte e tejkaluar dhe tani niveli kulturor ish ngritur mjaft...

Për afro 40 vjet rresht u përsërit, se pushteti proletar vinte duke u përsosur, ngaqë në vendet kyç kishte përditë e më shumë, njerëz të edukuar mirë, shërbëtorë të devotshëm e të

pakorruptueshëm të popullit. Ky ishte mendimi i patundur i të gjithë njerëzve në vendet kyç të këtij pushteti.

Këtë opinion e kundërshtuan në fillim disa individë e ata u pushkatuan. Që nga ajo ditë, askush nuk pati më mendim të kundërt.

Në vitet '60 e '70, çdo mëngjes, dy herë drejtpërsëdrejti e një herë tërthorazi, zyrat orientuese bënin të qartë, se nga humoristët nuk duhet të pickoheshin me drejtuesit në administratat e të gjitha niveleve. Burokratët përmbi kokat tona fituan mbrojtje të hapur nga dordoleci i përgjithësimit, që ato zyra e kishin ngulur në çdo parcelë të bostanit të madh socialist. Arti u shndërrua në një shkretëtirë mërzie pasi po të bëje, ta zëmë, një tregim a një portret letrar, mbi një lezhjan që një mëngjes gjen para shtëpisë një portofol të humbur dhe e dorëzon në polici, të rrihnin supet duke të thënë se kjo i bën nder lezhjanëve që si popull në përgjithësi i dorëzojnë portofolat e gjetur. Por që njëri ta gjejë portofolin, një tjetër më parë duhet ta humbë. As që donin t'ia dinin se, sipas përgjithësimit, lezhjanët dilnin si popull që dhe u binin portofolat nga xhepat! Kështu, pastaj, një drejtor që puthte sekretaren i bënte automatikisht tërë drejtorët imoralë dhe një zyrtar komiteti duhet të ish patjetër i mirësjellë që t'u hiqte tërë zyrtarëve nofkën e burokratëve.

Porosia ish që në art zyrtarët e të tashmes duheshin pasqyruar ashtu si do të ishin në të ardhmen. Ishin me dhjetëra zyrtarë që pushoheshin nga puna çdo ditë, por kjo i qe lënë Zyrave të Personelit. Artistët nuk duhet të dilnin nga binarët e pozitives “pasi ndryshe do të sillej një përfytyrim i shtrembëruar i realitetit socialist, i cili vit e për vit bëhej më i shkëlqyer”.

Dukej qartë që barrikatadat ngriheshin shumë, shumë më parë se goditja të shkonte tek objektet historikisht të